

Udhëzim i rëndësishëm

Të nderuar prindër dhe persona me përgjegjësi prindërore

Zotësia e gjuhës gjermane është një ndër faktorët më të rëndësishme për suksesin shkollor të fëmijës suaj / të fëmijëve tuaj. Dijeni të mira në gjuhën gjermane përbëjnë gjithashtu një bazë shumë të rëndësishme për një hyrje të suksesshme në jetën profesionale ose në shkolla të mëtejshme.

Në shkollë fëmijët me gjuhën amtare të huaj marrin me ofertën «Gjermanisht si gjuhë e dytë» (DaZ) një përkrahje efikase në mësimin e gjuhës gjermane. Por ne konstatojmë, që gjuha gjermane në shumicën e rasteve zotohet vetëm atëherë në mënyrë të mjaftueshme, nëse **fëmijët edhe jashtë shkollës të kenë sa më shumë kontakt me gjuhën zvicerano-gjermane ose gjermane.** Në këtë fëmijët varen nga ndihma juaj si prindër / persona me përgjegjësi prindërore! Prandaj ju sugjerojmë, që fëmijët tuaj ...

- ... në kohën e tyre të lirë të lozin shpesh me fëmijë që flasin zvicerano-gjermanisht ose gjermanisht (1).
- ... të shkojnë te familje ditore ku flitet zvicerano-gjermanisht ose gjermanisht (2).
- ... të jenë nën kujdesje tek tryezat e drekës (Mittagstisch) dhe tek kujdestaria «Hort», ku flitet në përgjithësi zvicerano-gjermanisht ose gjermanisht (3)
- ... në kohën e tyre të lirë të aktivizohen në shoqatat zvicerane lokale të sportit dhe të muzikës (4).
- ... të huazojnë në bibliotekë libra në gjuhën gjermane dhe t'i lexojnë ato (5).

Shikimi pasiv i filmave dhe i emisioneve televizive në gjuhën gjermane mund të kontribuojë, që fëmijët të kuptojnë gjuhën gjermane pak më mirë. Por shikimi i filmave dhe i emisioneve televizive nuk mjafton aspak, që fëmija juaj edhe të mund të flasë gjuhën gjermane në mënyrë të mirë dhe ta zotojë atë më mirë! Një efikasitet shumë më të mirë kanë pikat e lartcekura 1-5!

Parimisht është më e lehtë të mësohet gjuha zvicerano-gjermane ose gjermane para hyrjes në kopshtin e fëmijëve. Nëse keni edhe fëmijë të kësaj grupmoshe, atëherë pikat e lartcekura 1-3 kanë edhe rëndësi posaçërisht të madhe për fëmijët tuaj më të rinj.

Shumë faleminderit që i merrni parasysh këto informata të rëndësishme për të ardhmen e fëmijëve tuaj.

Shkolla komunale Horw



Daniel Bachmann
Rektor